

# A I DINI TË DREJTA TUAJA LIDHUR ME COVID-19

Virusi COVID-19, ka bërë që shumë njerëz me aftësi të kufizuara të frikësohen. Ju mund të shqetësoheni se do të sëmureni dhe nuk do të merrni trajtim. Personat me aftësi të kufizuara e dinë që diskriminimi ndikon në atë që merr kujdes mjekësor.

Ju duhet të ndiheni komod dhe të mbronin të drejtat tuaja kur jeni i sëmurë.

## INFORMOHUNI PËR TË DREJTAT TUAJA

- Ju keni të drejtën për marrjen e kujdesit shëndetësor ashtu si gjithë të tjerët. Nuk mund t'ju mohohet kujdesi vetëm sepse keni një aftësi të kufizuar dhe mund të keni nevojë për ndihmë shtesë.
- Spitalet publike duhet t'ju trajtojnë tërësisht falas ndërsa jeni të hospitalizuar .
- Politikat e spitalit për vizitorët kanë ndryshuar, për të ndaluar përhapjen e virusit. Spitalet mund të mos lejojnë vizitorë. Mund të bëjnë një përjashtim nëse keni nevojë për ndihmë për avokimin, komunikimin, mirëkuptimin ose vetë-kujdesin.
- Të drejtat tuaja civile nuk kanë ndryshuar. Kjo përfshin të drejtën për tu trajtuar në mënyrë të drejtë në spital. Trajtimi nuk duhet t'ju mohohet për shkak të aftësisë së kufizuar.

## VEPRONI ME KUJDES

- Larja e duarve mund të jetë e vështirë për disa njerëz. Bëni më të mirën tuaj. Mos harroni të pastroni pajisjet si p.sh. të karrigeve me rrota. Lajini, pastaj fshijini! Shënimet ose kohëmatësit pas saj mund t'ju ndihmojnë të kujtoheni.
- Mundohuni të ndryshoni mënyrën se si i bëni gjërat, për tu ekspozuar sa më pak ndaj mikrobeve. Vëzhgoni rutinat tuaja. Shikoni nëse ka gjëra që mund të ndryshoni për të qëndruar larg turmave. Qëndroni në shtëpi dhe qëndroni të sigurt.
- Mundohuni të prekni sipërfaqet e ndryshme sa më rrallë. Nëse duhet të prekni gjërat për të lëvizur ose për të komunikuar, lani duart ose përdorni pastrues. Ndoshta do të duhet të provoni mënyra të reja për të bërë gjërat gjatë kësaj kohe.
- Shmangia e të tjerëve mund të mos jetë gjithmonë e mundur. Mund t'ju duhet të keni një kontakt të ngushtë me kujdestarët tuaj. Bisedoni me kujdestarin tuaj se si mund të qëndroni të shëndetshëm. Nëse keni maska dhe doreza, ato mund t'ju ndihmojnë.

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.